



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 01.07.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58. a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040, nenit 9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve dhe Përfundimit 01 nr.06-43057 i dt: 30.06.2015 të konfirmuar për miratim nga Bordi i Drejtorëve përmes postës elektronike, me të cilin është miratuar propozimi që Shoqata e Familjarëve të Dëshmorëve- dega në Gjakovë të ndihmohet me subvencione të Zyrës së Kryetares së Komunës, me dt: 01.07.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

I. Miratohet kërkesa e Shoqatës së Familjarëve të Dëshmoreve - dega në Gjakovë, e evidentuar me nr. 01-400-7932 e dt: 28.01.2015, për mbështetje financiare të kësaj shoqate për mbulimin e shpenzimeve operative për periodën një vjeçare, duke e mbështetur me subvencione të Zyrës së Kryetares së Komunës në vlerë prej 1,800.00€.

II. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 1,800.00€ nga mjetet e subvencioneve të Zyrës së Kryetares së Komunës dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirrollogarinë e Shoqatës së Familjarëve të Dëshmoreve dega në Gjakovë, nr. 1704-0016-000039.09 Banka NLB.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

IV. Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative
- Z. Masar Binxhia, kryetar i Shoqatës së Familjeve të Dëshmoreve - dega në Gjakovë
- Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari-Lila